



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

**PROGRAMI I ZHVILLIMIT PROFESIONAL PËR MARRJEN E SHKALLËVE
TË KUALIFIKIMIT TË MËSUESVE TË LËNDËS “EKONOMI”,
2017**

1) HYRJE

Programi i zhvillimit profesional për efekt marrjen e shkallëve të kualifikimit të mësuesve të **ekonomisë** është hartuar nga grupi i punës, i ngritur nga Instituti i Zhvillimit të Arsimit (IZHA), për t’u ardhur në ndihmë të gjitha Drejtorive Arsimore Rajonale dhe Zyrave të Arsimit të rretheve, si dhe të gjithë mësuesve të lëndës së ekonomisë për t’u përgatitur për testimin kombëtar për marrjen e shkallëve të kualifikimit.

Programi është zhvilluar duke iu përgjigjur kërkesave që MAS-it ka vendosur për mësuesit që kualifikohen. Programi është hartuar duke mbajtur parasysh se fushat kryesore në të cilat testohen njohuritë dhe aftësitë e mësuesve janë:

- Dokumentet zyrtare¹ të cilat kanë të bëjnë me veprimtarinë mësimore – edukative të mësuesve;
- Programet përkatëse lëndore;
- Aspekte të pedagogjisë dhe të metodologjisë në mësimdhënie-nxënie;
- Aspekte të etikës dhe të komunikimit;
- Aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe;
- Përmbajtja shkencore e lëndës së ekonomisë, sipas programeve lëndore përkatëse.

2) QËLLIMI I PROGRAMIT

Programi i zhvillimit profesional për efekt marrjen e shkallëve të kualifikimit të mësuesve të **ekonomisë** është hartuar për të mbështetur dhe nxitur zhvillimin profesional të tyre. Programi është hartuar nga grupi i punës duke mbajtur parasysh përmbushjen e dy qëllimeve kryesore:

- *Së pari*, të ofrohet si një program orientues për t’u ardhur në ndihmë Drejtorive Arsimore Rajonale dhe Zyrave të Arsimit të rretheve si dhe të gjithë mësuesve të lëndës së ekonomisë të arsimit parauniversitar për të realizuar veprimtaritë

¹ Është fjala për të gjitha dokumentet ligjore, urdhëresat dhe udhëzimet e MASH që zbatohen në shkollë duke u përqendruar në ato të viteve të fundit.

kualifikuese dhe trajnuese në bazë rrethi. Në këtë aspekt programi mund të plotësohet nga DAR/ZA-të përkatëse, sipas kushteve dhe mundësive konkrete.

- *Së dyti*, ai të ofrohet si një program i detyruar, veçanërisht për mësuesit që këtë vit do të marrin shkallët e kualifikimit, në mënyrë që ata të realizojnë një përgatitje gjithëvjetoje, për të përballuar me sukses kërkesat që ka testimi kombëtar për efekt marrjen e shkallëve të kualifikimit.

Programi synon:

- Rritjen e përgjegjshmërisë së mësuesve për njohjen dhe zbatimin e legjislacionit arsimor e në mënyrë të veçantë të risive më të fundit të reformës arsimore.
- Rritjen e aftësive dhe kompetencave profesionale të kuadrit mësimdhënës, për të ndikuar drejtpërdrejtë në rritjen e efektivitetit të procesit mësimor, drejt një mësimdhënieje të suksesshme.
- Rritjen e përgjegjshmërisë së mësuesve për domosdoshmërinë e njohjes së koncepteve bazë dhe ligjësive shkencore të lëndës si dhe të zbatimit të tyre në praktikë, në përputhje me specifikat e moshës së nxënësve dhe të klasës ku japin mësim.
- Rritjen e përgjegjshmërisë së mësuesve për njohjen dhe zbatimin e rregullave të etikës dhe komunikimit në punën e tyre në shkollë.
- Rritjen e aftësive të mësuesve në drejtim të zbatimit me saktësi të rregullave drejtshkrimore të shqipes.
- Realizimin në praktikë nëpërmjet demonstrimit konkret të aftësive të fituara, e në mënyrë të veçantë nëpërmjet vlerësimit të arritjeve përmes testimit.

Objektivat afatshkurtër e programit

Programi synon që mësuesi:

- të njohë dhe të zbatojë legjislacionin arsimor dhe veçanërisht risitë më të fundit të reformës arsimore;
- të zotërojë kompetencat profesionale për të rritur efektivitetin e procesit mësimor dhe për të realizuar një mësimdhënie të suksesshme;
- të demonstrojë aftësitë në fushën pedagogjike për përzgjedhjen e metodave për menaxhimin e klasës, për shtjellimin e koncepteve, për nxitjen e diskutimeve, për përdorimin e teknikave të reja të vlerësimit të nxënësve etj.;
- të tregojë përgjegjshmëri në njohjen e koncepteve bazë dhe ligjësive shkencore të lëndës, si dhe në zbatimin e tyre në praktikë, në përputhje me specifikat e moshës së nxënësve dhe veçoritë e klasave ku japin mësim;
- të demonstrojë zbatimin e rregullave të etikës dhe komunikimit në punën e tyre në shkollë

3) PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Programi i zhvillimit profesional për efekt marrjen e shkallëve të kualifikimit të mësuesve të **ekonomisë** është strukturuar sipas fushave kryesore të përmendura më sipër të zhvillimit profesional, për të cilat testohen mësuesit. Për secilën fushë janë renditur njohuritë dhe aftësitë bazë që duhet të zotërojë mësuesi i lëndës së ekonomisë që të përmbushë me sukses rubrikat e testimit.

Programi është ndërtuar duke pasur si pikënisje standardet bazë të përgjithshme të mësuesit si dhe në standardet e mësuesit të lëndës së ekonomisë. Përshkallëzimi i kompetencave profesionale që lidhet me secilën fushë të testimit do ta ndihmojnë mësuesin që të identifikojë nevojat e tij si dhe çështjet në të cilat duhet të thellohet më shumë.

Për të qenë lehtësisht i përdorshëm, programi është paraqitur sipas një formati të caktuar. Sipas këtij formati, për secilën fushë prezantohen kompetencat që mësuesit duhet të zotërojnë në fushën e njohurive dhe aftësive si dhe literatura përkatëse rekomanduese që u vjen në ndihmë për zotërimin e këtyre kompetencave.

| PËRMBAJTJA E PROGRAMIT | |
|--|---|
| Fusha: Dokumente zyrtare | |
| Rezultati Mësuesi do të jetë i aftë: | Literatura |
| <ul style="list-style-type: none"> • të zotërojë njohuri për legjislacionin shkollor parauniversitar; • të zbatojë legjislacionin shkollor dhe udhëzimet e MAS-it; • të përshkruajë dokumentacionin shkollor të nevojshëm për mbarëvajtjen e procesit mësimor-edukativ në të gjitha hallkat e tij; • të vlerësojë risitë e dokumentacionit që po shqyrton; • të realizojë kuptimin, zbërthimin dhe përgjegjshmërinë në zbatimin e kërkesave të dokumentacionit shkollor; • të realizojë kuptimin, zbërthimin dhe përgjegjshmërinë në zbatimin e kërkesave të dokumentacionit lëndor. | <ul style="list-style-type: none"> • Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. • Urdhri për miratimin e Dispozitave Normative për arsimin parauniversitar (DN), nr. 343, datë 19.08.2013. • Udhëzimi nr. 16, datë 03.08.2016 për vitin shkollor 2016-2017, në sistemin arsimor parauniversitar. • Udhëzimi nr. 44, datë 16.10.2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 21, datë 23.07.2010 “Për normat e punës mësimore-edukative dhe numrin e nxënësve për klasë në institucionet e arsimit parauniversitar”. • Udhëzimi nr. 26, datë 15.08.2015 “Zhvillimi profesional i punonjësve arsimorë”. • Udhëzimi “Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve”, nr. 2, datë |

| | |
|--|---|
| | <p>12.02.2015.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Udhëzimi nr. 34, datë 11.09.2015 “Për vlerësimin e nxënësve për kurrikulën me kompetenca, në arsimin bazë”. • Udhëzimi nr. 14, datë 28.07.2016 “Për vlerësimin e nxënësve në arsimin e mesëm të lartë”. • Udhëzimi nr. 38, datë 06.10.2015 “Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar”. • Karta e performancës së shkollës. • Standardet e shkollës si qendër komunitare. |
|--|---|

Fusha: Programe lëndore

| Rezultati Mësuesi do të jetë i aftë: | Literatura |
|--|--|
| <ul style="list-style-type: none"> • të përcaktojë çfarë mësuesit duhet të dinë dhe të jenë të aftë të bëjnë për nxënësit; • të analizojë karakterin konkret dhe të qartë të përmbajtjes së kurrikulës; • të vlerësojë zbatimin cilësor të programit: kërkesat ndaj mësuesit si zbatues i programit lëndor; • të vërë në dukje të rishikimi i programit lëndor: kërkesat ndaj mësuesit si nismëtar i ndryshimit ose përmirësimit të programit lëndor; • të dallojë strukturën e programit lëndor dhe të përshkruajë përmbajtjen e rubrikave të saj; • të përshkruajë lidhjet ndërmjet njohurive të lëndës që jep mësim me njohuritë e disiplinave të tjera që zhvillohen në shkollë; | <ul style="list-style-type: none"> • Korniza kurrikulare ,2014. • Programi i lëndës “Ekonomi” për gjimnazin, për arsimin profesional dhe për arsimin e orientuar (social – kulturor) |

Fusha : Aspekte të pedagogjisë dhe të metodologjisë në mësimdhënie-nxënie

| Rezultati Mësuesi do të jetë i aftë: | Literatura |
|--|--|
| <ul style="list-style-type: none"> • të zhvillojë mësimdhënie në përshtatje me synimet dhe objektivat konkrete të lëndës që jep; • të zhvillojë koncepte dhe metoda që e bëjnë | <ul style="list-style-type: none"> • Literaturë që ka në fokus metodat e mësimdhënies ndërvepruese, me në qendër nxënësin. • Udhëzues dhe materiale mbështetëse që |

| | |
|--|--|
| <p>nxënësin të aftë për të zbatuar njohuritë e reja;</p> <ul style="list-style-type: none"> • të jetë i hapur për bashkëpunim dhe vlerësim të punës që bën; • të dallojë pyetjet e hapura dhe të mbyllura, të strukturuar dhe gjysmë të strukturuar. • të hartojë objektiva të nxënës; • të dallojë dhe të hartojë objektiva arritjeje në nivele të ndryshme; • të zbatojë njohuritë e tij për krijimin e një klime të përshtatshme të mësuarit në klasë; • të dallojë dhe të përzgjedhë metoda dhe teknika të përshtatshme me objektivat e të mësuarit dhe stilet e ndryshme të të mësuarit; • të strukturojë një ditari dhe të tregojë qëllimin e rubrikave të tij; • të përcaktojë synimet ose objektivat e kurrikulës në përputhje me filozofinë arsimore të përzgjedhur; • të alternojë metodat e punës individuale dhe asaj në grup në varësi të objektivave të të mësuarit; • të zbatojë teknika dhe forma të ndryshme të vlerësimit të nxënës; | <p>orientojnë për hartimin e objektivave të orës së mësimit, përgatitjen e ditarit të mësuesit, organizimin e orës së mësimit.</p> |
|--|--|

Fusha: Aspekte të etikës dhe komunikimit

| Rezultati Mësuesi do të jetë i aftë: | Literatura |
|---|---|
| <ul style="list-style-type: none"> • të përshkruajë parimet themelore mbi të cilat është hartuar kodi i etikës së mësuesit; • të dallojë sjelljet e mësuesit që burojnë nga parimet themelore; • të hartojë vetë një kod të thjeshtë sjelljeje që bazohet në parimet dhe standardet e kodit të etikës; • të përshkruajë sjelljet model që duhet të karakterizojnë zbatuesit e kodit të etikës së mësuesit, në varësi të funksionit që ka në komunitetin e shkollës; • të silllet në përputhje me rregullat e etikës dhe të sjelljes në marrëdhënie me drejtuesit, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe | <ul style="list-style-type: none"> • Kodi i Etikës së mësuesve në arsimin parauniversitar. • Literaturë dhe materiale burimore që trajtojnë çështje të etikës dhe të komunikimit. |

| komunitetin gjatë punës së tij brenda dhe jashtë institucionit arsimor. | | | |
|--|-------------------------------------|--|---|
| Fusha: Aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe | | | |
| Rezultati Mësuesi do të jetë i aftë: | | Literatura | |
| <ul style="list-style-type: none"> të zbatojë rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe standarde; | | <ul style="list-style-type: none"> Literaturë dhe udhëzues metodikë për përdorimin e rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe. | |
| Fusha: Përmbajtja shkencore e lëndës | | | |
| Nr. | Linja | Objektivat | Literatura |
| 1. | Çfarë studion ekonomia? | <p><i>Mësuesi të jetë i aftë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> të shpjegojë konceptet pamjaftueshmëri, sistem ekonomik, kosto oportune dhe lidhjen shkakësore ndërmjet pamjaftueshmërisë dhe nevojës për të zgjedhur, duke pranuar koston oportune. të japë shembuj personal lidhur me marrjen e vendimeve dhe koston oportune të saj; të identifikojë faktorët e prodhimit për një të mirë ose shërbim; të interpretojë një lakore të mundësive të prodhimit si dhe nëpërmjet saj të ilustrtojë koston oportune”; të vlerësojë mënyrën se si sisteme të ndryshme ekonomike e zgjidhin problemin ekonomik themelor; të përshkruajë veçoritë e shtyllave të sistemit ekonomik të iniciativës së lirë; të përshkruajë rolin e fitimit në sistemin e sipërmarrjes së lirë; të analizojë se si ndërmarrja e iniciativave ekonomike nxit përdorimin e burimeve natyrore, të kapitalit fizik dhe njerëzor; të përshkruajë fluksin e qarkullimit të aktivitetit ekonomik që lidh familjet, firmat e biznesit dhe qeveritë në ekonominë e tregut. | Tekstet e nxënësit dhe të mësuesit si dhe materiale të tjera ndihmëse |
| 2. | Kërkesa, oferta dhe çmimi i tregut. | <p><i>Mësuesi të jetë i aftë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> të interpretojë konceptet: treg, çmim, kërkesë, ofertë; | |

| | | | |
|----|------------------------------------|---|--|
| | | <ul style="list-style-type: none"> • të formulojë ligjin e kërkesës dhe ofertës; • të interpretojë lakoren e kërkesës dhe ofertës; • të shpjegojë faktorët që shkaktojnë zhvendosjen e kërkesës dhe ofertës; • të përcaktojë çmimin ekuilibër të një produkti të dhënë kur janë dhënë kërkesa dhe oferta për këtë produkt nëpërmjet grafikut; • të bëjë dallimin midis një ndryshimi në sasinë e kërkuar, apo ofruar dhe një ndryshimi në kërkesë, apo ofertë; • të vlerësojë ndikimin e ndryshimeve të elasticitetit të kërkesës në sasinë e kërkuar dhe të ndryshimeve të elasticitetit të ofertës në sasinë e ofruar. • të shpjegojë se si ndikojnë në çmimin e tregut ndryshimet në kërkesë dhe në ofertë; • të analizojë ndërveprimin e ligjit të kërkesës dhe ofertës në çmimin ekuilibër; • të shpjegojë se si çmimet e tregut bëjnë racionimin e mallrave dhe shërbimeve dhe motivojnë njerëzit për prodhimin e tyre; • të vlerësojë se si sistemi i tregut siguron plotësimin e nevojave të konsumatorëve; • të dallojë çmimin tavan nga çmimi dysheme; • të shpjegojë se si ndërhyrja e qeverisë mund të ndikojë tek tregu dhe sesi çmimet e tregut ofrojnë informacion dhe nxitje për konsumatorët dhe prodhuesit; • të analizojë raportin kosto-përfitim lidhur me ndërhyrjen e qeverisë në përcaktimin e çmimit të disa produkteve. | |
| 3. | Konsumatori në ekonominë e tregut. | <p><i>Mësuesi të jetë i aftë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • të përshkruajë rëndësinë ekonomike të konsumatorit në ekonominë e tregut si dhe burimet e të ardhurave të individëve dhe format e tyre; • të shpjegojë arsyet pse njerëzit kursejnë; • të krahasojë metodat e ndryshme të kursimit; • të analizojë faktorët që ndikojnë në masën e kursimit; • të përgatisë një buxhet personal; • të shpjegojë avantazhet dhe disavantazhet e blerjes me kredi. | |

| | | | |
|----|---|---|--|
| 4. | Fillimi i një biznesi dhe financimi i tij. | <p><i>Mësuesi të jetë i aftë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • të shpjegojë se si tregu i lirë inkurajon sipërmarrjen; • të listojë format kryesore të organizimit të biznesit. • të gjykojë mbi avantazhet dhe disavantazhet e secilës prej tri formave kryesore të biznesit; • të shpjegojë organizimin e korporatës • të gjykojë mbi disa nga përgjegjësitë, kërkesat dhe përfitimet që lidhen me sipërmarrjen; • të dallojë burimet e brendshme nga burimet e jashtme të financimit të biznesit; • të shpjegojë qëllimet dhe format e burimeve financiare të biznesit; • të dallojë ndryshimin midis aksionit dhe obligacionit; • të analizojë një bilanc dhe një pasqyrë të rezultateve financiare të firmës. | |
| 5. | Prodhimi, kostoja dhe të ardhurat e firmës. | <p><i>Mësuesi të jetë i aftë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • të bëjë dallimin midis kostove fikse dhe atyre variabël; • të llogarisë koston e përgjithshme të prodhimit, koston mesatare dhe atë marxhinale; • të interpretojë grafikun e kostos fikse, variabël, të përgjithshme, mesatare, marxhinale; • të llogarisë të ardhurat e përgjithshme, të ardhurat marxhinale dhe të ardhurat mesatare; • të llogarisë produktin e përgjithshëm fizik, marxhinal, mesatar; • të zbulojë veprimin e ligjit të të ardhurave zbritëse në gjendjen e biznesit; • të shpjegojë funksionin e prodhimit për periudhën afatshkurtër. | |
| 6. | Struktura e tregut. | <p><i>Mësuesi të jetë i aftë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • të interpretojë konceptet e konkurrencës dhe strukturës së tregut; • të identifikojë nivelin e konkurrencës së tregjeve në ekonomi; • të shpjegojë karakteristikat e secilës nga strukturat kryesore të tregjeve: konkurrencë e plotë, konkurrencë monopoliste, oligopol, monopol. • të diskutojë raportet dhe format e shkrirjes së | |

| | | | |
|----|--------------------------------------|--|--|
| | | <p>bizneseve;</p> <ul style="list-style-type: none"> • të krahasojë strukturat e ndryshme të tregjeve; • të analizojë efektet ekonomike të strukturave të tregut mbi ekonominë dhe konsumatorin; • të argumentojë se zhvillimi i konkurrencës së lirë është në favor të të gjithë subjekteve në ekonominë e tregut. | |
| 7. | Tregjet e faktorëve të prodhimit. | <p><i>Mësuesi të jetë i aftë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • të interpretojë ofertën dhe kërkesën për faktorët e prodhimit; • të interpretojë ofertën për punë dhe kërkesën për punë; • të shpjegojë se si kërkesa dhe oferta për punë përcaktojnë çmimin e punës, çmimin e kapitalit, çmimin e tokës; • të vlerësojë shkallën në të cilën forcat e tregut dhe forcat jo të tregut ndikojnë në pagat. | |
| 8. | Qeveria dhe ekonomia. | <p><i>Mësuesi të jetë i aftë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • të shpjegojë funksionin e qeverisë si arbitër dhe si subjekt në ekonominë e tregut; • të shpjegojë pse pjesëmarrja e qeverisë në ekonomi është rritur gjatë viteve; • të përshkruajë disa nga të ardhurat kryesore dhe shpenzimet në buxhetin për qeverinë shqiptare; • të shpjegojë arsyet që qeveria vendos taksa dhe pse taksimi nga qeveria është i nevojshëm; • të vlerësojë taksat, bazuar në parimet e vendosjes së tyre. • të krahasojë tipat e ndryshme të taksave, duke përfshirë taksat progresive, regresive dhe proporcionale; • të interpretojë konceptet e deficitit buxhetor, e borxhit publik dhe lidhjen midis tyre; • të analizojë përparësitë dhe mangësitë e deficitit buxhetor dhe borxhit publik; • të përshkruajë një ose disa propozime për të ulur deficitin buxhetor. | |
| 9. | Paraja dhe institucionet financiare. | <p><i>Mësuesi të jetë i aftë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • të interpretojë konceptin e parasë dhe karakteristikat e saj dhe funksionet e parasë në një ekonomi monetare; • të përshkruaj procesin e lindjes dhe të zhvillimit të parasë duke evidentuar format e saj; | |

| | | | |
|-----|--|--|--|
| | | <ul style="list-style-type: none"> • të identifikojë tipat e parasë në qarkullim, në vendin tonë. • të shpjegojë: ofertën monetare, rolin e veçantë të bankave si pranuese depozitash dhe dhënese huash për ekonominë si dhe domosdoshmërinë e rezervës së detyrueshme bankare; • të përshkruajë organizimin dhe funksionet e Bankës Qendrore të Shqipërisë. | |
| 10. | Treguesit kryesorë makroekonomikë. | <p><i>Mësuesi të jetë i aftë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • të përcaktojë treguesit që përdoren për të matur gjendjen e ekonomisë; • të shpjegojë konceptin e GDP dhe se çfarë përfshihet në llogaritjen e GDP; • të bëjë dallimin midis GDP reale dhe GDP nominale; • të analizojë kuptimin e GDP për frymë e shprehur në çmime aktuale dhe çmime konstante; • të përshkruajë metodat e matjes së GBP; • të japë kuptimin për inflacionin, deflacionin; • të dallojë inflacionin e shkaktuar nga kostoja nga inflacioni i shkaktuar nga kërkesa; • të shpjegojë ndikimin ekonomik të inflacionit dhe format kryesore të inflacionit; • të shpjegojë fazat kryesore të ciklit të biznesit. • të shpjegojë konceptin e forcës punëtore; • të dallojë format kryesore të papunësisë. | |
| 11. | Stabiliteti ekonomik dhe politikat makroekonomike. | <p><i>Mësuesi të jetë i aftë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • të përshkruajë mjetet e politikës fiskale. • të shpjegojë pse politikat fiskale janë vendime për të ndryshuar shpenzimet dhe/ose taksat nga qeveria; • të interpretojë efektet e drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta të politikës fiskale në papunësinë, prodhimin dhe normat e interesit; • të përshkruajë instrumentet e politikës monetare; • të dallojë instrumentet e politikës monetare nga ato të politikës fiskale; • të përshkruajë ndikimet dhe kufizimet e politikës fiskale si dhe ndikimet dhe kufizimet e politikës monetare; • të identifikojë rrugët në të cilat politika | |

| | | | |
|-----|------------------------|---|--|
| | | monetare ndikon në papunësinë, prodhimin, inflacionin dhe normat e interesit. | |
| 12. | Tregtia ndërkombëtare. | <p><i>Mësuesi të jetë i aftë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • të shpjegojë konceptet e përparësisë absolute dhe krahasuese; • të argumentojë përfitimet që kanë vendet e industrializuara kur këmbëjnë midis tyre; • të analizojë përmbajtjen e tregtisë së lirë dhe përfitimet ekonomike të saj; • të përshkruajë disa pengesa në tregtinë ndërkombëtare; • të japë në mënyrë të përmbledhur, argumentet që favorizojnë tregtinë e lirë; • të përshkruajë pse luhaten kurset e këmbimit valutor; • të bëjë dallimin midis bilancit të pagesave dhe bilancit tregtar. | |